

From: Association for Community Colleges (ACC)  
Subject: Readers letter  
To: The Independent, Irish Times, Le Monde, Liberation, Eesti Päevaleht, Postimees, Le Nouvel Observateur, Il Sole 24 ore, Il Corriere della Sera, La Stampa, Luxemburger Wort, El Pais, La Vanguardia, Frankfurter Allgemeine Zeitung, Die Zeit, Süddeutsche Zeitung, Der Kurier, Der Standard, Standart, Dnevnik, 24 Chasa, Lietuvos Aidas, Lietuvos zinios, Gazeta Wyborcza, The Slovak Spectator, Respekt, Vreme, Fljaka, Evenimentul Zilei, Jurnalul National, Rzeczpospolita, Polityka, The Daily Telegraph, The Economist, Ziarul Financiar, NRC Handelsblad, Volkskrant, Vrij Nederland, Naftemporiki, Europa Press, El Mundo, Berliner Zeitung, Ta Nea, Eleftherotipia, Diena, Latvijas Avize, Delo, Lidove Noviny, Politis, La Repubblica Padania, Tyzden, Hospodarske Hoviny, Il Gazzettino, Suomen Kuvalehti, Suomen Tietotoimisto Oy, Dagens Nyheter, Svenska Dagbladet, Aftonbladet, The Times, The Guardian, Hurriyet Gazetesi, Milliyet Gazetesi, Cumhuriyet, Kauno Diena, Jyllandsposten, De Standaard, De Morgen, Kristeligt Dagblad, Information, Público, Frankfurter Rundschau, Die Welt, Jornal Expresso, Diário de Notícias, Magyar Nemzet, Magyar Irlap, EUobserver, etc. etc.  
Release: November 30<sup>th</sup> 2005

## Wallström deshiron Eurofora - EuroTribune per nje sferë publike te perbashket!

Zevendes Presidenti i Komisionit Europian, Margot Wallström, duket te jete akoma me e vendosur ne thirrjen e saj per krijimin e nje tribune per qytetaret europiane per tu lidhur me njeri-tjetrin dhe per te vendosur kontakte me Institucionet Europiane per demokraci.

Qytetaret Europiane duhet te kene jo vetem mjetet per te komunikuar, por edhe te drejten qe zerat e tyre te degjohen, thote Wallström. Dhe ajo vazhdon qe mbushja e boshllekut midis Europes dhe qytetareve te saj, do te thote qe ne duhet te krijojme nje tribune takimi per debat civil. Akoma me e rendesishme eshte kjo per nivelin e demokracise ne Europe!

Ne e kemi marre ne konsiderate kete supozim te Znj. Wallström, besimin e saj se Komisioni Europian mund dhe duhet te mbeshtese konkretizimin e nje vargu perlash te Universiteteve Civile ne Europe. (Svenska Dagbladet e Suedise ne Qershor 4 psh). Keto institucione ne vende te tjera jane quajtur si Kolegje te Komunitetit Europian, Akademite e Njerezve, Shkolla te Mesme Europiane per Qytetare dhe/ose Eurofora - qe do te thote se ne po merremi me "teste ne fushe" per sfera publike ne shkalle te ulet, duke ndertuar komunitete mesimi nga grupe te ndryshme Eurpianesh, ndoshta jo-formale dhe brenda formatit te shkolles.

Ne e konsiderojme si nje ide te shkelqyer krijimin e mundesive per europianet qe te takohen dhe te diskutojne ceshtje te nje interesi te perbashket qe dalin mbi kufijte, rajonet, klasat sociale si dhe ndarje te tjera ndermjet europianeve. Ne besojme fuqimisht se « vendosja e urave » ne hendekun qe ekziston mes europianeve dhe institucioneve te tyre politike, shpie ne bashkimin e europianeve me njeri-tjetrin. Cfare tjetër do te donim te kishim ne fund te ketyre urave ?

E kemi provuar per vite me rradhe dhe e dime qe funksionon. Vizioni per nje sferë publike europiane dhe nje shoqëri civile drejt zhvillimit, eshte potencialisht me e gjere se BE (ceshtja e vendeve jashte BE-se). Ja perse do te donim te kishim ndihmen e Shqiperise dhe Maqedonise. Eshte nevoja per te bindur te dyja palet, shtetasit e Shqiperise dhe te Maqedonise si dhe qeverite e tyre per te qene te vemendshem ndaj kesaj ideje !

Kemi theksuar se ideja per tu krijuar kushte europianeve per tu takuar, eshte permendur deri me tani vetem ne letrat e lexuesve dhe ne fjalimet e Znj. Wallström, nderkohe qe dokumentet zyrtare te BE-se i referohen me shume komunikimit mes Komisionit te BE dhe qytetareve. Me kete do te donim qe te terhiqim vemendjen ndaj vizionit te Znj. Wallström per komunikim dhe dialogim ndermjet qytetareve europiane si nje kusht per arritjen realisht te demokracise Europiane

Asociacioni per Kolegje Komunitare - Association for Community Colleges (ACC)

John Petersen (Århus); Conchi Gallego (Madrid); Jan-Christoph Napierski (Brussels); Mjellma Mehmeti (Skopje); Emma Yeoman (Cambridge); Elisabeth Alber (Meran); Dasa Bolcina (Trieste); Erik Jentges (Berlin), Lucie Cizkova (Prague), Edlira Xhafa (Kassel) dhe Arlind Dinollari (Tirana).

Impressum: [www.acc.eu.org](http://www.acc.eu.org)

Presskit: [www.acc.eu.org](http://www.acc.eu.org)

Contact: John Petersen, chairman, 0045 2425 3068